UDHËZIM
Nr.45, datë 19.12.2011

PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 58 pika 3 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Çdo student në momentin e pranimit duhet të regjistrohet në regjistrin bazë të studentëve. Çdo studenti, në regjistrimin fillestar në një institucion të arsimit të lartë (IAL), i jepet një numër unik matrikullimi, që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës.

2. Studentët e marrin numrin e matrikullimit (NIM) të përbërë nga gjashtë germa dhe dy shifra të kodit të regjistrit dhe katër shifrat e numrit të studentit në regjistrin përkatës. Formimi i numrit të matrikullimit është sipas shtojcës nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Në rast se një student largohet ose transferohet nga një fakultet pa e përfunduar kursin e studimit, NIM-i i tij mbyllet dhe nuk përdoret për një student tjetër.

4. Regjistrat e studentëve për një vit akademik, në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, të organizohen në bazë njësie kryesore (fakulteti), cikli studimi dhe formë studimi.

5. Çdo regjistër të ketë një kod të vetin, unikal në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, i përbërë nga gjashtë germa dhe dy shifra. Germa e gjashtë e kodit të regjistrit përcaktohet në bazë të ciklit të studimit dhe formës së studimit, sipas shtojcës nr.2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Kodet e regjistrave në përdorim për çdo institucion të arsimit të lartë, përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP).

7. Për hapjen e një regjistri IAL, duhet të aplikojë në AKP për të marrë kodin e regjistrit përkatës.

8. Brenda një fakulteti regjistrat bazë të studentëve të organizohen më vete për çdo formë studimi (sistemi me kohë të plotë, kohë të pjesshme, edukim në distancë, etj.) dhe për secilin cikël studimi (cikli I, cikli II dhe cikli III).

9. Institucionet e arsimit të lartë i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP), listën e studentëve të regjistruar në vitin akademik 2011-2012 e në vazhdim, në programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në formë shkresore dhe elektronike (hardcopy dhe në CD), në format EXCEL, sipas shtojcës nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi, sipas afatit të përcaktuar në udhëzimin respektiv për regjistrimet. IAL-të të dërgojnë të dhënat në AKP, sipas afatit të përcaktuar në udhëzimin respektiv për regjistrimet.

10. AKP brenda 1 muaji i dërgon institucioneve të arsimit të lartë, listën përkatëse të numrave të matrikullimit për çdo student.

11. AKP përgatit rregulloren teknike të administrimit dhe sigurisë së bazës shtetërore (kombëtare) të të dhënave të studentëve.

12. Udhëzimi nr.19, datë 18.7.2007 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit", i ndryshuar, shfuqizohet.

13. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj